



Prishtinë: 27.12.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1218_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1998_11_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **17.12.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 27.12.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin I. M. nga Mitrovica, me shifër të konsumatorit **DMI – 9053455** si e pa bazuar.
- II **MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1998_11_19** i datës 18.11.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 17.12.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: ngarkesa me shërbimin 118€ e datës 08.03.2017 është taksë për lidhje të re pasi që konsumatori ka tejkuluar pëlqimin për 64 banesa dhe 2 lokale dhe ka ndryshuar projektin fillestar për fuqinë prej 433.2 kW. Në ankesë thuhet se faturimi i taksës për lidhje të re është konform metodologjisë që taksave për kyçje. Në ankesë theksohet se konsumatori, investitorit i është dorëzuar Pëlqimi Elektroenergjetik dhe si tillë nuk vlen në rastin e ndryshimit të projektit. Në ankesë theksohet se sipas pikës 5 të Pëlqimit Elektroenergjetik theksohet se në rastet kur ndryshohet projekti nga konsumatori atëherë duhet të kërkohet edhe pëlqim energjetik plotësues. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1998_11_19 të datës 18.11.2019 për konsumatorin I.M. me shifër DMI - 9053455.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se ngarkesa me shërbimin 118.00€ e datës 08.03.2017 është taksë për lidhje të re pasi që konsumatori ka tejkuluar pëlqimin për 64 banesa dhe 2 lokale dhe



ka ndryshuar projektin fillestar për fuqinë prej 433.2 kW, Bordi i ZRRE-së thekson se investitori "Ariani" Naser Imeri ka parashtruar kërkesë te Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – KEDS për kyçje në rrjetin elektrik për objektin banesor – afarist me 64 banesa dhe 2 lokale, dhe nga KEDS me datë 20.10.2014 ka marrë Pëlqimin Elektroenergjetik (PEE) nr.324/2014. Në këtë PEE janë dhënë të gjitha kushtet teknike të cilat investitori duhet të realizoj në mënyrë që objekti banesor të mund të energjizohet. Në PEE vërehet se fuqia maksimale e njëkohëshme $P_{mnj}=433.2$ kW sipas projektit dhe se KEDS në emër të fuqisë së angazhuar, zgjerimit të kapaciteteve prodhuese, bartëse dhe distributive, investitori është i obliguar që KEDS-it t'i paguajë shumën prej 7,746.48€, ku në këtë vlerë përfshihet vlera nga fuqia e angazhuar prej 6,498.00€, vlera e shërbimit të kyçjes 180.00€, dhe vlera e TVSH sipas ligjit 1068.48€. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se investitori dhe ka marrë faturën nga KEDS për pagesën e PEE dhe të cilën faturë e ka paguar, pra vërehet se investitori ka paguar tërë kapacitetin e kërkuar nga vet ai. Lidhur me atë se investitori apo konsumatori ka ndryshuar projektin, duhet theksuar se sipas shkresave të lëndës konsumatori I.M. një lokal e cila ka qenë në kuadër të projektit fillestar e ka ndarë në dy pjesë, madje edhe kapaciteti i kërkuar për ndarjen e lokalit nuk është tejkaluar, por është brenda kapacitetit të dhenë në Pëlqimin Elektroenergjetik.

Sa i përket pikës së kundërshtimit së KESCO se sipas pikës 5 të Pëlqimit Elektroenergjetik theksohet se në rastet kur ndryshohet projekti nga konsumatori atëherë duhet të kërkohet edhe pëlqim energjetik plotësues, Bordi i ZRRE thekson se gjatë shqyrtimit të shkesave të lëndës në asnjë prej shkresave të KEDS apo të KESCO nuk është theksuar se me kërkesën e konsumatorit I.M. a kemi rritje të kapacitetit nga ajo që ka paguar investitori apo jo. Bordi i ZRRE thekson se është e saktë se në rastet kur aplikuesi për kyçje tejkalon fuqinë e kërkuar atëherë aplikuesi duhet të bëjë kërkesë për pëlqim energjetik shtesë dhe se kjo nuk është aspak kontestuese. Gjithashtu Bordi i ZRRE thekson se përgjigja e KESCO dhenë konsumatorit nuk është e arsyetuar mirë, pasi nuk qartëson saktë se e kemi të bëjmë me kërkesë shtesë të lidhjes së re e që nënkupton kërkesë shtesë për kapacitet nga ajo e përcaktuar në PEE prej 433.2 kW, dhe sa është kërkesa shtesë e kapacitetit. Bordi i ZRRE-së thekson se nëse kërkesa shtesë e aplikuesit (ndarja e lokalit) është në kuadër të kapacitetit prej 433.2 kW dhënë në PEE, atëherë siç u theksua edhe më lartë konsumatori nuk do të duhej të ngarkohej me taksë shtesë për kapacitet, pavarësisht procesverbalit të pranimit të instalimit nr.0095475 të datës 02.03.2017, pasi që aplikuesi për kyçje veç se ka paguar tërë kapacitetin e paraparë për atë objekt. Ndërsa në rastet kur KEDS do të konstatonte se kërkesa për lidhje të re e tejkalon kapacitetin e paguar nga aplikuesi atëherë do të duhej të refuzohej dhe udhëzohej aplikuesi që të paguaj për kapacitet shtesë kur kushtet teknike lejojnë një gjë të tillë.

Sa i përket pikës së kundërshtimit së KESCO se faturimi i taksës për lidhje të re është konform metodologjisë që taksave për kyçje, Bordi i ZRRE-së thekson se në Kreun III të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji janë të përshkruara të gjitha hapat nga aplikimi për kyçje në rrjetin elektrik e deri te kyçje fizike e objektit të parashtruesit të kërkesës për kyçje. Sipas nenit 7 paragrafi 1 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, *"Operatorët e sistemit duhet të zhvillojnë Metodologjinë e taksave për kyçje në përputhje të plotë me Metodologjitë Tarifore të miratuara nga ZRRE-ja"*. Sipas Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji dhe Procedurës Lidhëse, konsumatorët të cilët aplikojnë për lidhje të re faturohen me taksën për shërbime për lidhje të re bazuar në çmimet e aprovuara nga ZRRE, e në të cilën janë të përshkruara dhe paraqitura të gjitha taksat që duhen të zbatohen nga operatorët me rastin e aplikimit për kyçje të re. Duhet theksuar se neni 5, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.5 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thekson se: *"Operatori i Sistemit duhet të: bëjë kyçjen në rrjet të çdo aplikuesi nëse kjo kyçje është teknikisht e mundshme sipas kushteve të vendosura në Marrëveshjen për Kyçje, dhe ta ngarkojë me taksë të përcaktuara në pajtim me metodologjinë të përcaktimit të taksave të kyçjes"*, si dhe neni 5, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.8 i k Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, thekson se: *"Operatori i Sistemit duhet të: arkëtojë prej*



shfrytëzuesve të sistemit taksat për shfrytëzim të sistemit". Pra Bordi i ZRRE-së thekson se nuk është asgjë kontestuese në këtë pikë pasi që të gjithë aplikuesit për kyçje pas aplikimit për kyçje duhet të paguajnë për taksën për kapacitetin e kërkuar (ngarkuar) dhe taksën për kyçje, dhe se investitori këtë e ka bërë kur ka paguar kapacitetin 433.2 kW, por që në rastet kur nuk kemi rritje të kapacitetit të kërkuar atëherë nuk duhet të bëhet pagesa pasi është në kuadër të këtij kapaciteti të paguar.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit I.M. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.